

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE HULUMTIMIT

"PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM"



**Treguesit më të ri makroekonomik
Rishikim i gjendjes aktuale**

shtator, 2024

Treguesit më të ri makroekonomik

Rishikim i gjendjes aktuale - ndikimet mbi politikën monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale ka për qëllim të jep një pasqyrë të të dhënave më të reja makroekonomike (qershor - gusht 2024) dhe krahasim me parashikimet e fundit makroekonomike (prill 2024). Me këtë do të përcaktohet se si gjendja aktuale në ekonomi korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të parashikimeve. Rishikimi është i fokusuar në ndryshimet e supozimeve dhe arritjeve të jashtme të variablat e brendshme dhe mënyrën se si këto ndryshime reflektojnë në ambientin e udhëheqjes së politikës monetare.

Vlerësimet e rritjes ekonomike globale¹ për periudhën 2024 - 2025 janë të ngjashme me muajin prill dhe tregojnë për stabilizim. Rreziqet rreth rritjes globale vlerësohen sikur të balancuara dhe lidhen kryesisht me tensionet gjeopolitike dhe inercinë e inflacionit, kryesisht në çmimet e shërbimeve, duke ruajtur kështu politikën monetare kufizuese për një periudhë më të gjatë kohore, e cila rritë rreziqet e jashtme, fiskale dhe financiale. Rreziqe të tjera përfshijnë rritje të mundshme më të dobët se sa pritej në Kinë, rritje të fragmentimit gjeo-ekonomik, barriera të ndryshme tregtare me një efekt negativ në tregti dhe ndryshimet klimatike. Përkundrazi, zbatimi më i shpejtë i reformave strukturore, përdorimi më i fortë i kursimeve të akumuluar më parë, veçanërisht në vendet e zhvilluara, lëvizja më e fortë rënëse e çmimeve botërore të produkteve parësore sesa pritej, ulja më e shpejtë e inflacionit dhe e normave të interesit mund të ketë një efekt pozitiv mbi rritjen.

Duke parë përmes treguesve të veçantë sasiore të mjedisit të jashtëm domethënës për ekonominë e Maqedonisë, vlerësimi i rritjes së kërkesës së huaj efektive për vitin 2024 ruhet, ndërsa për vitin 2025 ka një korigjim minimal në rënie në krahasim me projeksionet e prillit. Te inflacioni i huaj efektiv është bërë rishikim në rënie për vitin 2024, ndërsa parashikimi për vitin 2025 është e njejtë sikur në prill. Te kursi valutor euro/USD-dollar pritet një zhvlerësim më i vogël të USD-dollarit në raport me prillin e tërë periudhës së parashikimit. Rishikimet në çmimet botërore të produkteve primare janë kryesisht në rënie, ku çmimet ende pritet të bien kryesisht në vitin 2024 dhe rritja e tyre në vitin 2025. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e produkteve primare janë jashtzakonisht të ndryshueshme dhe nën ndikim të fuqishëm nga zhvillimet e lidhura me luftën në Ukrainë dhe konfliktin ushtarak në Lindjen e Afërt, që shkakton një pasiguri të madhe rreth dinamikës së tyre të ardhshme dhe efekteve ndaj ekonomisë globale dhe të brendshme.

Për sa i përket normës së interesit të huaj EURIBOR me maturim njëmuor, vlerësohet rënia më e ngadaltë e saj gjatë viteve 2024 dhe 2025 krahasuar me muajin prill, duke pasur parasysh ngadalësimin e pritur më të ngadaltë të inflacionit bazë në eurozonë. Njëkohësisht, në mbledhjen e shtatorit BQE-ja uli për 0,25 p.p. Normën e interesit të depozitave të disponueshme², në vlerësimin e një aktiviteti real ekonomik më të dobët se sa pritej në Eurozonë dhe një ngadalësim të inflacionit total në pajtim me pritjet, me presione më të moderuara nga shpenzimet për fuqinë puntore dhe reduktimi i fitimeve. Kështu, në parashikimet e shtatorit të PBB-së nuk janë bërë ndryshime te inflacioni krahasuar me qershorin, me të cilin pritet ai të arrijë 2,5%, 2,2% dhe 1,9% në vitet 2024, 2025 dhe 2026, përkatësisht, derisa vlerësimet për rritjen ekonomike janë të rishikuara paksa në

¹ Sipas raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Pasqyrë Ekonomike Botërore", korrik 2024.

² Normat e interesit të operacioneve bazë për rifinancim dhe të kredive të disponueshme njëditore ulen për 0,60 p.p., në pajtim me ndryshimin e fundit në kornizën operative për menaxhimin e politikës monetare të BQE-së nga 13.03.2025, e cila do të hyjë në fuqi në 18.09.2024. Sipas kornizës së re, norma e interesit për depozitat e disponueshme do të përdoret si normë bazë e interesit për menaxhimin e politikës monetare, ndërsa niveli i dy normave tjera të interesit do të caktohet nëpërmjet një hendeku fiks, kështu që hendeku i ndërmjet normës së interesit të operacioneve bazë për rifinancim dhe të depozitave të disponueshme ulet dhe do të arrijë 0,15 p.p., ndërsa hendeku ndërmjet normës së interesit të kredive të disponueshme njëditore dhe të operacioneve për rifinancim do të mbesë i pandryshuar, pra 0,25 p.p. ([lidhje interneti](#)).

rënie dhe parashikohet rritje prej 0,8% në vitin 2024, e cila do të rritet në 1,3% në vitin 2025 dhe 1,5% në vitin 2026³.

Treguesit më të ri të ekonomisë së brendshme tregojnë një paraqitje makroekonomike e cila nuk devijon ndjeshëm nga vlerësimet e prillit. Në tremujorin e dytë të vitit 2024 **rritja reale e PBB-së përshpejtoi dhe shënon 2,3% në bazë vjetore** (rritje prej 1,2% në tremujorin paraprak), me rritje të mëtejshme në bazë tremujore (sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së). Arritja është pothuajse e njëjtë me vlerësimin për rritjen vjetore në tremujorin e dytë të ciklit të parashikimit të prillit. Analizuar sipas komponentave, rritja kryesisht vjen nga kontributi pozitiv i eksportit neto, me një rënie me të fortë të importit nga eksporti i mallrave dhe shërbimeve. Kontribut të vogël pozitiv ka pasur edhe kërkesa e brendshme, e cila është rezultat i rritjes së konsumit të amvisërive dhe konsumit publik, ndërsa investimet bruto pësuan rënie (për shkak të reduktimit të inventarëve, me rritjen e investimeve në mjete fikse). Të dhënat me frekencë të lartë për tremujorin e tretë të vitit 2024 me të cilat disponon për momentin janë të kufizuara. Për momentin, të dhënat e muajit korrik tregojnë një rritje reale vjetore të qarkullimit në totalin e prodhimit tregtar dhe industrial, kundrejt rënies së tyre në tremujorin e mëparshëm. **Në gusht 2024, norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohej, duke zbritur në 2.2%** (3.0% në korrik) dhe është identike me normën e parashikuar nga cikli i projeksionit të prillit. Në të njëjtën kohë, norma vjetore rezultoi kryesisht nga komponenti bazë i inflacionit dhe ngadalësimi i rritjes së çmimeve vjen si pasojë e lëvizjeve më të favorshme në të tre komponentët kryesorë, me rënie të çmimeve të komponentëve ushqimorë dhe energjitikë dhe rritje të ngadaltë të inflacionit bazë. Sipas anketës së muajit gusht, **pritjet e konsumatorëve** për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë sërish në drejtim të uljes së çmimeve. **Hendeku i inflacionit në Eurozonë** mbetet relativisht i ngushtë. Rishikimet në raport me çmimet e importit për momentin janë kryesisht në rënie e pasiguria e dinamikës së ardhshme e çmimeve të produkteve primare në bursa shkakut i tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike është ende e pranishme.

Rezervat valutore në fund të gushtit të vitit 2024 shënojnë 4.469,8 milionë euro. Analiza e treguesve të përshtatshmërisë së rezervave valutore tregon se ato edhe më tej mbahen në zonën e sigurtë. Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në korrik 2024 për momentin tregojnë në deficit tregtar për tremujorin e tretë të vitit që është disi më i lartë se sa pritej në pajtim me parashikimin e prillit. Të dhënat për veprimtarinë e këmbimit përfundimisht me muajin gusht, tregojnë në të hyra-neto nga transferimet private të cilat janë disi më të larta se sa pritej për tremujorin e tretë në pajtim me parashikimin e prillit. Deficiti i realizuar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në tremujorin e dytë të vitit 2024 është më i ulët se sa pritej në pajtim me parashikimet e prillit, gjatë realizimit të njëkohshëm të të hyrave financiare neto më të ulëta.

Lidhur me **zhvillimet e sektorit monetar, depozitat** totale në korrik 2024 janë më të larta për 7,5% në bazë vjetore, me një rritje të parashikuar për tremujorin e tretë prej 9,0% sipas parashikimit të prillit. Rritja e **totalit të kredive** në sektorin privat në korrik 2024 janë më larta për 7,3%, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e tretë prej 6,1% sipas parashikimit të prillit. Rritja e kredive të reja të miratuara ka ardhur në rritje që nga fillimi i vitit, si rezultat i të dy sektorëve (ndërmarrjeve dhe individëve). Konkretisht, shumica e totalit të kredive të reja në sektorin privat në 12 muajt e fundit me përfundim në korrik, mesatarisht është më i lartë në bazë vjetore.


Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën prej janar - korrik 2024 është arritur deficit prej 21.755 milionë denarë, ose 48,7% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 (në pajtim me ribalancin e Buxhetit nga gushti 2024). Deficiti buxhetor është financiar përmes debitimit neto të shtetit të tregut të brendshëm dhe të huaj, me rritje të njëkohshme të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

³ Sipas parashikimit të qershorit 2024, rritja e parashikuar e aktivitetit ekonomik ishte 0,9% në 2024, dhe 1,4% dhe 1,6% në 2025 dhe në 2026, përkatësisht.

Arritjet e treguesve kryesorë makroekonomikë, si dhe vështirimet më të fundit në lidhje me ecurinë e tyre në të ardhmen, aktualisht janë ruajtur brenda pritshmërive të parashikimeve të fundit. Norma vjetore e inflacionit në gusht u ngadalësua ndjeshëm dhe u ul në 2,2%, që është në nivel të parashikimit. Në anketat e fundit të Komisionit European vazhdojnë të mbizotërojnë pritjet të konsumatorëve për uljen e çmimeve në periudhën e ardhshme. Pritjet për çmimet e produkteve primare në bursa janë gjithashtu pak më të favorshme, megjithëse ato janë ende të ndryshueshme dhe të ndikuara nga konteksti i paqëndrueshëm gjeopolitik. Rritja e ekonomisë vendase në tremujorin e dytë të vitit 2024 u përshpejtua dhe është pothuajse identike me atë të parashikuar dhe të dhënat e disponueshme për tremujorin e tretë të 2024 janë të kufizuara dhe për momentin tregojnë për tendenca më të favorshme në industri dhe tregti. Nga aspekti i tregut valutor, zhvillimet edhe më tej janë të favorshme, që kontribuoi për blerjen e konsiderueshme neto të valutave nga Banka Popullore nga fillimi i vitit. Potenciali depozitar i bankave është solid dhe për momentin me parashikime për arritje më të mira nga prijat për tremujorin e tretë. Të ngjashme janë arritjet edhe te rritja e kredisë, e cila mbahet pak mbi të parashikuarin.

Tregues të përzgjedhur makroekonomik / 1								2023												2024														
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korrr.	gush.	sht.	tr.3	tet.	nën.	dhj.	tr.4	2023	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korrr.	gush.
I. Treguesit e sektorit real																																		
Produkti bruto i brendshëm (ritja reale vjetore) ^{1/2}	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5	2.2				1.4				0.9				1.0				0.9	1.0				1.2			2.3			
Prodhimi industrial ^{1/3}																																		
norma e ndryshimit (vjetore)	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	-0.2	-2.3	1.0	1.2	0.1	-1.6	6.1	3.7	2.7	-1.7	-5.1	4.5	-0.6	9.9	-2.4	-5.8	0.4	0.6	2.9	0.3	-10.5	-3.1	-1.1	-13.1	-6.5	-7.1	3.8	
norma mesatare kumulative	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	-0.2	-2.3	-0.5	0.1	0.1	-0.3	1.0	1.5	1.5	1.0	0.3	0.8	0.8	1.7	1.3	0.6	0.4	0.6	2.9	1.5	-3.0	-3.0	-2.6	-4.9	-5.1	-7.1	-3.9	
Inflacioni ^{1/4}																																		
CPI inflacioni (vjetore) ^{1/5}	-0.2	2.4	0.9	0.4	2.3	4.9	18.7	17.1	16.7	14.7	16.1	13.0	11.3	9.3	11.2	8.4	8.3	6.6	7.7	3.5	3.1	3.6	3.4	3.6	3.2	3.0	4.0	3.4	4.0	4.5	3.2	3.9	3.0	2.2
CPI inflacioni (mesatare kumulative)	-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	14.2	17.1	16.9	16.1	16.1	15.3	14.5	13.6	13.6	12.8	12.2	11.5	11.5	10.7	9.9	9.4	9.4	9.4	3.2	3.1	3.4	3.4	3.6	3.8	3.7	3.7	3.6	3.4
Inflacioni bazë (mesatare kumulative)	1.3	2.3	1.5	0.5	0.9	2.4	7.1	10.8	10.6	10.2	10.2	10.2	9.9	9.6	9.6	9.3	9.0	8.7	8.7	8.5	8.2	8.0	8.0	8.0	5.1	4.9	5.0	5.0	4.7	4.9	4.9	4.9	5.0	5.0
Inflacioni bazë (vjetore) ^{1/5}	1.0	2.8	1.4	-0.3	1.9	2.9	10.8	10.8	10.4	9.5	10.2	10.1	8.9	8.2	9.1	7.4	7.1	6.3	7.0	6.2	6.2	5.4	5.9	5.5	5.1	4.7	5.1	5.0	4.1	5.5	4.7	4.8	5.6	5.3
Fuqia punëtore																																		
Norma e papunësisë ^{1/1}	23.7	22.3	20.6	17.1	16.2	15.4	14.4				13.3				13.1				12.8				13.0	13.1				12.9			12.5			
II. Treguesit e sktorit fiskal																																		
(Buxheti qendror dhe Buxheti i fondeve)																																		
Gjithsej të hyrat buxhetore	169,356	179,673	188,505	203,822	189,554	218,021	243,085	19,268	18,749	27,991	66,009	21,207	22,294	21,639	65,140	22,594	22,005	21,728	66,326	26,865	24,128	28,677	79,669	277,144	21,447	23,193	24,777	69,417	28,891	23,739	22,246	74,876	28,836	
Gjithsej shpenzimet buxhetore	185,407	196,581	200,071	217,445	243,421	256,906	278,596	20,681	23,003	25,849	69,533	30,183	24,814	30,202	85,199	26,057	22,007	22,249	70,313	24,370	27,518	41,633	93,521	318,566	26,948	28,897	28,240	84,085	28,633	31,381	24,054	84,088	26,731	
Bilanci buxhetor (para të gatshme bazë)	-16,051	-16,888	-11,566	-15,623	-53,867	-38,885	-35,511	-1,413	-4,254	2,142	-3,524	-8,976	-2,520	-8,563	-20,059	-3,464	-3	-521	-3,987	2,495	-3,390	12,956	-13,852	-41,422	-5,501	-5,704	-3,463	-14,668	259	-7,642	-1,808	-9,192	2,105	
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{1/1}	-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-0.2	-0.5	0.2	-0.4	-1.0	-0.3	-1.0	-2.3	-0.4	0.0	-0.1	-0.5	0.3	-0.4	-1.5	-1.6	-4.8	-0.6	-0.6	-0.4	-1.6	0.0	-0.9	-0.2	-1.0	0.2	
III. Treguesit financiar ^{1/6}																																		
Paraja e gjerë (M4), norma vjetore e rritjes	6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	5.1	4.5	5.7	6.9	6.9	8.6	10.5	11.4	11.4	10.6	9.8	8.8	8.8	8.3	7.4	8.7	8.7	8.7	10.0	9.5	9.5	9.5	9.3	8.5	7.6	7.6	7.6	
Totali i kredive, norma vjetore e rritjes	-0.1	5.4	7.3	6.0	4.7	8.3	9.4	6.6	7.7	6.6	6.6	6.3	6.5	6.5	6.5	5.8	6.4	5.8	5.8	5.3	5.2	5.1	5.1	5.1	5.7	6.5	6.1	6.1	6.8	6.8	6.4	6.4	7.3	
Totali i kredive të popullsisë	7.0	9.2	10.3	10.5	8.0	7.8	7.3	7.4	7.2	6.8	6.8	6.7	6.5	6.4	6.4	6.4	6.7	6.4	6.4	6.3	6.5	6.7	6.7	6.7	6.9	7.2	6.8	6.8	7.0	7.0	7.1	7.1	7.5	
Totali i kredive të ndërmarrjeve	-5.3	2.3	4.5	1.9	1.1	8.7	11.5	9.7	8.2	6.2	6.2	5.9	6.5	6.5	6.5	5.0	5.8	5.1	5.1	4.1	3.8	3.3	3.3	3.3	4.3	5.9	5.4	5.4	6.6	6.4	5.8	5.8	7.3	
Totali i depozitave (me para të depozituara), norma vjetore e rritjes ^{1/7}	6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	4.9	4.5	5.9	6.9	6.9	8.7	10.7	11.6	11.6	11.2	10.2	9.0	9.0	8.3	7.4	9.1	9.1	9.1	10.3	9.6	9.6	9.6	9.6	9.6	8.6	7.6	7.6	
Totali i depozitave të popullsisë	2.5	6.1	9.5	7.9	4.6	7.1	5.8	5.9	6.3	8.4	8.4	8.3	8.7	8.8	8.8	8.4	7.0	6.8	6.8	6.8	7.1	7.9	7.9	7.9	7.8	8.6	8.7	8.7	10.8	10.2	8.9	8.9	9.6	
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	13.4	2.1	9.5	14.6	10.1	11.6	3.7	2.6	5.7	5.9	5.9	12.0	17.8	19.7	19.7	18.9	19.0	15.7	15.7	14.1	9.8	13.2	13.2	13.2	15.9	12.3	12.2	12.2	8.0	5.0	4.7	4.7	3.9	
Normat e interesit ^{1/8}																																		
Norma e interesit e bonovo të bankës qendore (në fund të muajit/tremujorit/vitit)	3.75	3.25	2.50	2.25	1.50	1.25	4.75	4.75	5.25	5.50	5.50	5.50	5.75	6.00	6.00	6.00	6.15	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	
Normat e interesit të huadhenies																																		
në denarë	7.0	6.6	6.1	5.6	5.2	4.9	4.6	5.1	5.1	5.2	5.1	5.2	5.2	5.3	5.2	5.6	5.7	5.7	5.7	5.8	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzura)	5.7	5.3	4.9	4.6	4.3	4.1	4.0	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	5.3	5.3	5.2	5.3	5.2	5.2	5.1	5.2	5.1	5.1	5.1	5.0	5.1	5.0	5.0	5.0	4.9		
Normat e interesit të depozitave																																		
në denarë	2.5	2.2	2.0	1.9	1.5	1.2	1.1	1.3	1.4	1.5	1.4	1.6	1.6	1.8	1.7	1.9	2.0	2.0	2.0	2.1	2.2	2.3	2.2	1.8	2.2	2.3	2.3	2.2	2.3	2.3	2.4	2.3	2.4	
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzura)	1.0	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.4	0.6	0.7	0.8	0.7	0.9	0.9	1.0	0.9	1.1	1.2	1.2	1.2	1.3	1.3	1.4	1.3	1.0	1.3	1.3	1.4	1.4	1.4	1.5	1.5	1.4	1.5	
IV. Treguesit e sektorit të jashtëm																																		
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në milionë euro)	-252.5	-78.3	22.4	-334.7	-318.0	-329.0	-797.4	-17.0	18.4	91.4	92.8	-94.6	22.6	-52.9	-124.9	129.2	28.3	81.7	239.2	3.5	1.7	-117.0	-111.7	95.3	-43.4	-83.5	-68.2	-195.1	-53.4	-54.6	-3.7	-111.7		
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)	-2.6	-0.8	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	-0.1	0.1	0.7	0.7	-0.7	0.2	-0.4	-0.9	0.9	0.2	0.6	1.8	0.0	0.0	-0.9	-0.8	0.7	-0.3	-0.6	-0.5	-1.3	-0.4	-0.4	0.0	-0.8		
Bilanci tregtar (në milionë euro) ^{1/9}	-1,786.2	-1,816.2	-1,811.4	-2,007.7	-1,816.6	-2,715.7	-3,829.7	-228.1	-196.1	-209.3	-633.5	-195.6	-215.2	-241.9	-652.6	-201.4	-309.6	-210.3	-721.3	-277.6	-239.2	-301.5	-818.2	-2825.7	-249.8	-287.1	-271.3	-808.2	-306.7	-286.8	-213.1	-806.6	-307.5	
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-18.0	-18.1	-16.9	-17.8	-16.7	-22.9	-29.4	-1.7	-1.4	-1.5	-4.6	-1.4	-1.6	-1.8	-4.8	-1.5	-2.3	-1.5	-5.3	-2.0	-1.8	-2.2	-6.0	-20.7	-1.7	-2.0	-1.9	-5.6	-2.1	-2.0	-1.5	-5.5	-2.1	
Importi (në milionë euro)	4,176.5	4,834.9	7,676.3	8,441.0	7,594.5	9,638.3	12,130.8	949.4	915.0	995.2	2,759.6	857.3	985.1	936.0	2,778.3	897.4	864.8	947.8	2,710.0	983.2	957.5	959.8	2,900.5	11,148.5	800.5	944.4	992.7	2,737.6	1,018.9	890.5	887.3	2,806.7	945.6	
Eksporti (në milionë euro)	4,390.3	5,018.7	5,872.4	6,433.1	5,777.9	6,922.6	8,301.2	621.3	718.9	785.9	2,126.1	661.7	769.9	694.1	2,125.7	696.0	555.2	737.4	1,988.7	705.6	718.4	658.4	2,082.3	8322.8	550.6	657.3	721.5	1,529.4	712.2	603.8	694.2	2,000.1	638.1	
Norma e rritjes së importit (vjetore)	6.																																	

Kërkesa e huaj efektive
(ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Vlerësimi i **kërkesës së huaj** për vitin 2024 mbetet e pandryshuar në raport me prillin....

...ndërsa për vitin 2025 është bërë korrigjim i vogël në rënie, kryesisht si reflektim i vlerësimit për një rritje më të ulët të PBB-së në Gjermani⁴.

Inflacioni i huaj efektiv
(ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Rishikim i vogël në rënie i **inflacionit të huaj efektiv** për vitin aktual, në krahasim me prillin, kryesisht shkaku i inflacioni më të vogël të vlerësuar në Itali dhe Bullgari...

...ndërsa për vitin 2025 vlerësim janë të pandryshuara, ku edhe më tej pritët ngadalësim i dinamikës së rritjes.

Kursi euro/USD-dollar



Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.


Pritjet janë për zhvlerësim më të vogël të vlerës së **USD dollarit në raport me euron** për gjithë periudhën e parashikimeve, krahasuar me prill...

...kryesisht shkaku i pritshmërive për uljen e normave të interesit, në kushte të arritjeve më të dobëta ekonomike në SHBA.

⁴ Rritje të parashikuar të Gjermanisë prej 0,1% dhe 1% në 2024 dhe 2025, respektivisht, kundrejt nga 0,1% dhe 1,2% në prill.

Nafta "brent"

(mesatarja tremujore, euro/fuqi)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-

Pritshmëritë për çmimet e produkteve primare janë kryesisht të rishikuara në rënie, nën ndikim të pritshmërive për rritje të ofertës dhe kërkesës më të dobët...

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro

(ndryshime vjetore në %)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-

...me përjashtim të çmimit të bakrit, për të cilin pritet rritje të kërkesës lidhur me investimet në burime të ripërtëritshme të energjisë.


Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Euribor-i njëmuor
(mesatarja tremujore, në %)



Pritjet për ulje më të ngadaltë të **Euriborit njëmuor** në gjithë periudhën e parashikimeve, duke marrë parasysh mbajtjen e inflacionit bazë në eurozonë në nivel më të lartë.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Indeksi i stresit financiar




Treguesi për stresin global financiar⁵ vazhdon të tregojë luhatshmëri në tregjet financiare.

⁵ Tregues KFI IFS (ang. OFR, FSI) e mat stresin sistematik financiar - çrregullime në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 tregues të ndryshueshëm të tregut financiar, të grupuar në pesë kategori treguese: Kredi, vlerësim të kapitalit, financim, fonde të sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e treguesit, në ditë të caktuar paraqet nivel mesatar të ponderuar të çdo luhatje të shënuar atë ditë, lidhur me vlerën e tij historike, ku treguesi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit

(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.


Në gusht 2024, çmimet e brendshme të konsumit shënuan rritje prej 0,5% në bazë mujore (0,7% në korrik), me rritje të çmimeve të ushqimit dhe inflacionit bazë.

Çmimet e ushqimeve u rritën me 1.3%, thuasjse tërësisht si pasojë e rritjes së çmimeve të perimeve, pjesërisht e ndikuar nga faktorët sezonalë, pas rënies së çmimeve në tre muajt e mëparshëm.%,

Çmimet e energjisë shënuan rënie mujore prej 0.8%, më së shumti si pasojë e uljes së çmimeve të derivateve të naftës, në përputhje me lëvizjet e bursave botërore dhe në masë më të vogël si pasojë e uljes së çmimeve të ngrohjes qendrore⁶.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë


(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Inflacioni bazë në baza mujore shënoi një rritje të lehtë prej 0.2%, e cila erdhi kryesisht si pasojë e çmimeve më të larta të rregulluara të furnizimit me ujë. Nga ana tjetër, ulje të konsiderueshme ka të çmimet e transportit ajror.

Norma vjetore e inflacionit në muajin gusht vazhdoi të ngadalësohej dhe u ul në 2,2% (3,0% në korrik), e cila vjen si pasojë e tendencave më të favorshme në të tre komponentët kryesorë, d.m.th. rënies së çmimeve të komponentëve ushqimorë dhe energjisë dhe rritjes më të ngadaltë të inflacioni bazë.


Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p)

Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë vijon të mbahet në nivele relativisht të ulëta.


⁶ Komisioni Rregullator i Energjetikës (KRrE) mori vendim sipas së cilës nga gushti çmimet e energjisë termike për amvisëritë do të jenë më të ulëta për 3,16% ([lidhja](#)).

Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë



Burimi: Eurostat.


Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Pritjet e konsumatorëve⁷ të dhëna në anketat e gushtit për lëvizjet e çmimeve në periudhën e ardhshme vazhdojnë të tregojnë ulje e lehtë të tyre, por më dobët në krahasim me pritjet në korrik.

Parashikimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve për inflacionin në 3 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)




Burimi: Komisioni Evropian.

Në raport me **sektorin korporativ**⁸, në gusht pritjet për zhvillimet e çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të ulëta se të gjitha sektoret.

⁷ Anketa e Komisionit Evropian për optimizmin e konsumit nga gushti 2024, në bazë të çështjes për "pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm".

⁸ Anketa për tendencat afariste të Komisionit Evropian në industrinë, tregtinë me pakicë, ndërtimtarinë dhe sektorin e shërbimit.

Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimeve dhe pijeve joalkolike (indeks, 2015=100)




* Çmimet e huaja efektive të ushqimeve paraqesin shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: EShS-ja, Eurostat-i dhe llogaritje të BPRMV-së.

Norma vjetore e realizuar e inflacionit në gusht është me normën e parashikuar nga cikli i parashikimeve të prillit. Nga pikëpamja strukturore, inflacioni bazë është i ngjashëm me atë të parashikuar, rënia e çmimeve të ushqimeve është më e dobët se sa pritej, dhe komponenti energjetik ka shënuar rënie, në vend të rritjes së pritshme.

Rishikimet e **lëvizjeve të pritshme të supozimeve hyrëse të jashtme** te parashikimi i inflacionit për vitin 2024 janë kryesisht në drejtim rënës. Megjithatë, ka ende pasiguri dhe rreziqe të mëdha për dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare.

Paga mesatare e paguar (normat vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

Në qershor 2024, rritja vjetore e **pagës mesatare nominale neto** u përshpejtua dhe arriti në 14.8% (13.1% në muajin paraardhës),...

... që vjen si pasojë e përshpejtimit të rritjes së pagave në sektorin e shërbimeve, posaçërisht në veprimtaritë "veprimtari financiare dhe veprimtari të sigurimeve" dhe "veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe ndihmëse" dhe në një masë më të vogël veprimtaritë "profesionale shkencore dhe teknike" dhe "administrata publike, mbrojtja dhe sigurimet e detyrueshme sociale" ...

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve (normat nominale vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

... ndërsa të ngjashme janë edhe zhvillimet te **paga reale neto**, rritja e së cilës gjithashtu përshpejtoi në qershor.

Normat e realizuara të rritjes së pagave nominale dhe reale vjetore në tremujorin e dytë 2024 janë më të ulëta krahasuar me projeksionin e prillit.

Prodhimi i brendshëm bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja dhe parashikime të BPRMV-së.

Të dhënat e parashikuara janë të rregulluara për sezonalitet, por dallimet në seritë për periudhën e realizuar mund të paraqiten edhe si pasojë e rishikimeve të rregullta të EShS-së.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, rritja reale e PBB-së përshejtoi dhe arrin 2,3% në bazë vjetore (rritje prej 1,2% në tremujorin paraprak), që është në linjë me parashikimin...

... që në masë të madhe i detyrohet kontributit pozitiv të eksporteve neto, në kushtet e rënies më të madhe të importeve në raport me eksportet. Kontribut të vogël pozitiv ka edhe kërkesa e brendshme, me rritje të konsumit personal dhe publik dhe rënie të investimet bruto (për shkak të uljes së furnizimeve).

Parë nga ana e prodhimit të PBB-së, pjesa më e madhe e veprimtarive shënojnë rritje, por kontribut më të madh pozitiv ka grupi i aktiviteteve "tregti, transport dhe hotelieri". Nga ana tjetër, te industria dhe bujqësia përsëri vërehet kontribut negativ.

Në bazë tremujore, PBB-ja shënoi rritje reale prej 0,8%⁹.

Duke pasur parasysh sasinë e kufizuar të të dhënave të disponueshme për ofertën dhe kërkesën, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë i gjendjes së përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e tretë të vitit 2024.


Rezultatet e hulumtimit të anketës për periudhën korrik-gusht 2024 tregojnë për perceptime më të favorshme në bazë vjetore, ndërkohë që krahasuar me tremujorin paraprak, ato janë pothuajse të pandryshuara¹⁰.

Në korrik, **qarkullimi i totalit të tregtisë** shënon një rritje reale në bazë vjetore, i udhëhequr nga tregtia me shumica dhe tregtia me pakicë...

... me rritje edhe te **industria prodhimit**, përkundër rënies në tremujorin paraprak...

... nën ndikim të industrisë së përpunimit (në masë më të madhe për shkak të prodhimit të produkteve ushqimore dhe prodhimit të

Treguesi i besueshmërisë ekonomike dhe PBB-ja




Burimi: EShS-ja dhe Komisioni Evropian.

⁹ Sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendarike të ESHS-së.

¹⁰ I referohet anketave të zbatuara nga Komisioni Evropian për matjen e besueshmërisë ekonomike të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik fitohet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe tregusve të besimit për sektorë të caktuar ekonomik (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

Veprimtaritë ekonomike (ndryshimet reale vjetore, në %)



* Mësimet e thjeshtë e normave të ndryshimit vjetorë të mënyrave të ndryshme të transportit dhe telekomunikacionit.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.


energjisë elektrike) dhe minierave, ndërsa të energjia vërehet rënie e lehtë.

PRODIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	kor
	<i>ndryshime reale vjetore në %</i>										
Produkti i brendshëm bruto	1.7	4.0	1.8	1.5	1.4	0.9	1.0	0.9	1.2	2.3	-
Prodhimi industrial	3.5	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.7	0.4	-3.0	-7.1	3.8
Punë ndërtimore të realizuara	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	-
Ndërtim i lartë	-26.6	12.4	-10.0	6.2	12.2	-20.0	-9.8	-18.3	-34.0	-5.3	-
Ndërtim i ulët	4.2	-13.4	-26.9	-27.2	10.5	-22.6	-7.2	37.1	31.6	48.6	-
Punë ndërtimore të specializuara	-27.3	-55.3	-21.9	43.5	69.0	10.6	-21.2	11.3	-3.3	98.0	-
Qarkullim në tregti - Gjithsej*	-11.7	-16.7	-17.4	-23.7	-11.1	-8.4	-7.3	-2.2	-8.6	-7.7	5.9
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	-10.5	-14.9	-16.5	-21.3	-14.0	-11.7	-13.0	-4.1	-9.6	-8.7	7.3
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	-14.7	-20.4	-19.3	-28.4	-4.8	-2.0	4.3	1.4	-6.5	-5.9	7.4

* Normat reale të rritjes janë përllogaritur nga BPRMV-ja, duke përdorur normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 janë të dhëna preliminare. Të dhënat e PBB-së për vitin 2022 janë preliminare, ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 janë të vlerësuara.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.

Treguesit e lëvizjes së konsumit privat (normat reale vjetore, në %)



Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.


Të dhënat e disponueshme për lëvizjet e **konsumit personal** për korrikun 2024 lëvizin kryesisht në kah rritës (rritje e pensioneve, kredive për popullsinë, importit të mallrave të konsumit, tregtisë me pakicë dhe prodhimit vendas të mallrave të konsumit), me përjashtim të të ardhurave bruto nga TVSH-ja, të cilat shënojnë rënie.

Lidhur me të dhënat me frekuencë të lartë për **investimet bruto**, lëvizjet janë në drejtime të ndryshme...

...me rritje të kredisë afatgjatë për ndërmarrjet dhe importit të kapitalit qarkullues, ndërkohë që investimet kapitale shtetërore, prodhimi vendas i mallrave kapitale dhe tatimi mbi fitimin shënuan rënie.

Të dhënat për **shkëmbimin e tregtisë së jashtme** në korrik 2024 tregojnë për një rritje të mundshme të deficitit krahasuar me të

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)



njëttën periudhë të vitit të kaluar, me rënie nominale të eksporteve dhe rritje të importeve.

Arritjet buxhetore në pajtim me të dhënat fiskale për korrik 2024 tregojnë për një rritje reale vjetore të **konsumit publik**.


Treguesit kryesor të tregut të punës¹¹ në tremujorin e dytë të vitit 2024 shënojnë lëvizje të moderuara në bazë vjetore.

Norma e punësimit arrin 45,6% dhe është minimalisht më e lartë në bazë vjetore (për 0,1 p.p.), në kushte të rritjes së vogël vjetore të numrit të punonjësve për 0,3%.

Norma e papunësisë vazhdoi me zhvillimin në rënie dhe ra në 12,5% (ulje prej 0,6 p.p. në bazë vjetore), me ulje të numrit të papunësuarve në bazë vjetore për 5,3%


Nga pikëpamja e ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e dytë është vërejtur ulje e lehtë e popullsisë aktive (për 0,4%), në kushte të rritjes të popullsisë joaktive (për 0,5%).

¹¹ Rezultatet nga Anketa e Fuqisë Puntore (AFP) sipas tremujorëve të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të kaluar nga vitet e kaluara, sepse në vitin 2023 është zbatuar Rregullativa e re (BE) nr. 2019/1700 të Parlamentit Europian dhe Këshillit për Statistikë Sociale dhe rregullativën përkatëse ekzekutuese të Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për zonën e fuqisë puntore, ndërsa Rregullativa e mëparshme (BE) nr. 577/98 është hequr. Zbatimi i rregullativës së re shkaktoi ndryshime në hulumtimin, duke filluar me ndryshime në dizajnin e pyetësorit, ndryshimin e renditjes së pyetjeve, ndryshime dhe largim të pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në përfshirje dhe definimin e punësisë dhe papunësisë. Për këtë, analiza është bërë vetëm mbi bazën e të dhënave krahasuese nga viti 2023 e tutje.




Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në korrik 2024 u rrit për 52,7% në bazë vjetore, me rritje në importin dhe njëkohësisht rënie në eksportin e mallrave.

Importi i mallrave në korrik 2024 shënoi rënie prej 8,3% në bazë vjetore, kryesisht për shkak të eksportit më të ulët të një pjese të kapaciteteve të prodhimit në pronësi të huaj nga industria e automjeteve. Arritjet në eksport janë më të ulëta se sa pritej sipas parashikimit të prillit, më së shumti si pasojë e eksportit të një pjese të objekteve prodhuese në pronësi të huaj, si dhe të pjesës tjetër të eksportit dhe eksportit të hekurit dhe çelikut.




Importi i mallrave në korrik 2024 shënoi rritje prej 5,4% në bazë vjetore, për të cilën kontribut më të madh kanë importi më i lartë i pajisjeve dhe makinave, si dhe importi i ushqimit, i plotësuar me rritjen e importit të mallrave për konsum të gjërë dhe të automjeteve. Arritjet në importe janë aktualisht më të ulëta se sa pritej në muajin prill, me devijime në rënie në importet e lëndëve të para të një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj që lidhen me industrinë e automobilave.

Deficiti tregtar në korrik 2024 është aktualisht në përputhje me atë që pritej sipas projeksionit të prillit, por periudha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të sakta.





Në korrik të vitit 2024, KREK-u i deflatuar me kostot e jetës shënoi zhvlerësim prej 1,7% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i KREK-ut i llogaritur me çmimet e prodhimit të produkteve industriale shënoi mbivlerësim prej 1,2%.

...gjatë mbivlerësimit të KKEN-it për 0,7% (kryesisht shkaku i zhvlerësimit të lirës turke në raport me denarin), rënie e kostove relative të

KNEK (kursi nominal efektiv i këmbimit) dhe çmimet relative, normat vjetore të ndryshimit, në %


jetës dhe rritje e vogël e çmimeve relative të produkteve industriale.

Në drejtim të njejtë janë edhe ndryshimet e treguesve të KREK-ut të llogaritura pa produktet primare.

KREK, duke përjashtuar lëndët e para
normat vjetore të ndryshimit, në %**Komponentët e llogarisë rrjedhëse**
(në milionë euro)


Në tremujorin e dytë të vitit 2024, llogaria rrjedhëse shënoi deficit prej 111,7 milionë euro, ose 0,8% të PBB-së, që është më i ulët se sa pritej sipas parashikimeve të prillit...

...me sufiicit më të lartë të arritur në shërbime dhe njëkohësisht flukse neto më të ulëta në të ardhurat dytësore, në realizime në deficitin tregtar në përputhje me pritjet.


Komponentët e llogarisë financiare
(në milionë euro)

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, në llogarinë financiare janë realizuar hyrje


neto¹² prej 71,2 milionë euro (ose 0,5% nga PBB-ja), të cilat janë më të larta nga pritjet në pajtim me parashikimin e prillit (hyrje neto nga investimet e pritura te investimet direkte dhe huamarrjet afatshkurtëra dhe dalje neto më të ulëta te valutat dhe depozitat).



Blerja neto e tregut të këmbimit i realizuar në periudhën 01.07.2024 - 30.08.2024 për momentin tregon për arritje te transferimet private që janë pak më të larta se pritjet për tremujori e tretë, në pajtim me parashikimin e prillit.




Rezervat valutore bruto në fund të gushtit të vitit 2024 shënojnë 4.469,8 milionë euro dhe shënojnë rritje në raport të fundit të tremujorit të dytë, që në pjesë më të madhe vjen si pasojë e blerjes së realizuar me intervenimet e Bankës Popullore për menaxhim me rezervat valutore.




¹²Sipas metodologjisë së re për përgatitjen e bilancit të pagesave (BPM6), terminet të hyra neto dhe të dala neto shënojnë krijimin e detyrimit neto dhe fitim neto të mjeteve, respektivisht.

SEKTORI I JASHTËM

Në periudhën 01.07 - 31.08 të vitit 2024, në tregun valutor të bankave është regjistruar blerje neto me e ulët valutore që është më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në kushte të rritjes së moderuar dhe të ofertës valutore...




...zhvendosjet e tilla të tregut valutor tërësisht vijnë nga blera neto më e ulët nga jorezidentët dhe personat fizik në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.




Instrumentet monetare

(gjendja në fund të muajit, në milionë denarë)



Gjendja e instrumenteve monetare në fund të korrikut 2024 shënoi ulje krahasuar me muajin paraprak, që vjen si pasojë e shumës së konsiderueshme më të ulët të mjeteve të bankave të vendosura në depozita te Banka Popullore.

(gjendja në fund të vitit, në milionë denarë)




Burimi: BPRMV


Niveli i instrumenteve monetare në fund të korrikut është më i ulët krahasuar me nivelin e parashikuar për fundin e tremujorit të tretë 2024, me mjete neto valutore pak më të larta të Bankës Kombëtare, por me një devijim më të theksuar në rritje të depozitave shtetërore dhe niveli më i lartë i parasë primare se ai i parashikuar.

Gjithsej depozitat

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



* Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozitat e institucioneve të tjera financiare, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive tek bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve të tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale tek Banka Popullore.

Arritjet e parasë primare në fund të korrikut janë mbi vlerat e parashikuara sipas parashikimit të prillit, me një devijim në rritje si në paranë e gatshme në qarkullim ashtu edhe në totalin e rezervave të bankave në Bankën Kombëtare.


Totali i depozitave¹³ në sistemin financiar në korrik 2024 shënuan rritje mujore prej 0,5%. Nga aspekti sektorial, rritja vjen nga depozitat e amvisërive, ndërsa nga aspekti valutor më i madh është kontributi në depozitat në valutë të huaj.

Depozitat totale gjatë korrikut 2024 realizuan rritje në raport me fundin e tremujorit të dytë, i cili është pak më i ulët në krahasim me rritjen e pritur për tremujorin e tretë, në pajtim me parashikimin e prillit.

Norma vjetore e rritjes së depozitave totale në korrik 2024 është 7,5% dhe e njëjta për momentin është nën normën e parashikuar për tremujorin e tretë të vitit 2024 prej 9,0% sipas parashikimit të prillit.


¹³ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshetëror të bankave dhe kursimoreve, mjeteve të institucioneve tjera financiare në llogaritë të BPRMV-ja dhe mejetet e njëjste të vetqeverisjes lokale në llogaritë të BPRMV-ja. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-

Depozitat e individëve
(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




Në korrik 2024, **depozitat e amvisërive shënuan rritje në baza mujore**, e cila vjen më së shumti si pasojë e rritjes së depozitave në valutë vendase (përfshirë paranë e depozitave), si dhe rritjes së depozitave afatgjata, për nga struktura afatgjata. Në bazë vjetore, depozitat e amvisërive në korrik 2024 shënojnë rritje prej 9,6%.

(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV.

Depozitat në denarë dhe në devizë / totali i depozitave të individëve
(pjesëmarrja në fund të muajit, në %)




Në korrik është vërejtur një rritje e lehtë e pjesëmarrjes së depozitave në denarë në strukturën valutore të totalit të depozitave të amvisërive, që tregon për përforsim të denarizimit.

(pjesëmarrja në fund të vitit, në %)




* Totali i depozitave vetem tek bankat dhe kursimoret.
Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë M4
(kontributet në p.p., ndryshime mujore)




(kontributet në p.p., ndryshime vjetore)




Pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në denarë në totalin e M4

(të dhënat në fund të muajit, në %)



(të dhënat në fund të vitit, në %)



Burimi: BPRMV

Oferta monetare, e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, ka arritur një rritje prej 0.6% në korrik 2024, e cila rezulton nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve nga **këndvështrimi valutor dhe maturimi (me përjashtim të depozitave afatshkurtra, të cilat shënojnë një kontribut shumë i vogël negativ).**


Në nivel vjetor, oferta monetare në korrik 2024 shënoi rritje prej 7,6%, që për momentin është mbi rritjen e pritur vjetore prej 8,8% për tremujorin e parë të vitit 2024, sipas parashikimit të prillit.

Pjesëmarrja e pjesës së denarit në ofertën totale monetare M4 në korrik 2024 është nivel me muajin paraprak dhe është mbi vlerën e parashikuar për tremujorin e tretë të vitit.

Kreditë totale në korrik shënuan rritje mujore prej 0,6%.

Gjithsej kreditë


(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




Gjatë korrikut 2024, kredia totale ka shënuar rritje krahasuar me fundin e tremujorit të dytë, e cila është pak më e lartë se rritja e pritur për tremujorin e tretë të vitit, sipas parashikimit të prillit.

Norma vjetore e rritjes së totalit të kredive në korrik arrin 7,3%, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e tretë të vitit 2024 prej 6,1%.



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Burimi: BPRMV.

Kredi të reja të sektorit privat, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes


Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, në korrik 2024, shënoi rritje të përsheptuar me bazë vjetore, si rezultat i rritjes së kredive në të dy sektorët (ndërmarrje dhe amvisëri).

Kredi të reja të amvisërive, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes

Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12m mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes



Raporti ndërmejt kredive dhe depozitave totale

(të dhënat mujore, në %)



Treguesi për shfrytëzimin e potencialit depozitues të bankave për kreditimin e sektorit privat në muajin qershor është 83.2% dhe është mbi vlerën e këtij treguesi të parashikuar në fund të tremujorit të tretë 2024 (81.6%), sipas parashikimeve të prillit.


(të dhënat vjetore, në %)



Burimi: BPRMV

Normat e interesit të gjithsej depozitave

(të dhëna mujore, në %)




Totali i depozitave

Depozitat e reja

Në korrik 2024 **normat e interesit të depozitave totale në denarë dhe valutore**¹⁴ u mbajtën në nivelin e muajit paraprak, kështë që diferenca e interesit mbeti në nivelin prej 0,9 p.p.. Lëvizje në rritje të normave të interesit në këtë muaj ka të **depozitat e reja në denarë dhe në**

(të dhëna vjetore, në %)



Totali i depozitave


Depozitat e reja

— Diferenca e interesit, në p.p.
 — Norma e interesit të depozitave në denarë
 — Norma e interesit të depozitave në devizë


Burimi: BPRMV

¹⁴ Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

Normat e interesit të depozitave të individëve (të dhëna mujore, në %)





totalin e depozitave të reja valutore,¹⁵ ndërsa diferenca e interesit u rrit në 1,0 p.p. (rritje mujore për 0,2 p.p.)...



Burimi: BPRMV

...lëvizje pothuajse identike në korrik janë vërejtur edhe te normat e interesit te **sektori "amvisëri"**.

Normat e interesit të gjithsej kredive, sipas sektorëve (të dhëna mujore, në %)




Burimi: BPRMV.

Në korrik 2024, norma e interesit të **kredive¹⁶ të reja të ndërmarrjeve** shënojnë rritje, ndërsa normat e interesit të **totalit të kredive të ndërmarrjeve** shënojnë rënie të lehtë në raport me muajin paraprak. Normat e interesit të totalit të kredive të reja të amvisërive janë të pandryshuara në raport me muajin paraprak.

¹⁵ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshon) dhe norma e tyre e interesit.

¹⁶ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshohet) dhe norma e tyre e interesit.


Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në %) dhe
diferenca e tyre (në p.p)



Diferenca në normat bazë të ineteresit të Bankës Popullore dhe të Bankës Qendrore Europiane është e qëndrueshme dhe e pa ndryshuar.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Në korrik të vitit 2024, të hyrat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) shënuan rritje të përsheptuar të konsiderueshme vjetore, e cila ishte kryesisht për shkak të rritjes së të hyrave tatimore, dhe në masë më të vogël rritja e të ardhurave nga kontributet. Shpenzimet buxhetore shënojnë rritje më të moderuar (kryesisht nga transferimet më të larta), me një rënie të njëkohshme të kostove kapitale.

Në periudhën janar - korrik 2024, të hyrat totale buxhetore janë më të larta për 12,6% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa të dalurat buxhetore janë më të larta për 7,8%...

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive,

(Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor




...deficiti i realizuar buxhetor në shumë prej 21.755 milionë denarë paraqet 48,7% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 në pajtim me ribalancin e Buxhetit ¹⁷...


¹⁷ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 169 nga 15.08.2024..

Financimi i bilancit buxhetor

(në milionë denarë)




...i njëjti është financuar përmes debitimit neto të shtetit në tregut e brendshëm, në pjesë më të vogël edhe në tregun e huaj, me rritje të depozitave të shtetit në Bankën Popullore.




* Ndryshimi pozitiv: ulje e depozitave tek BPRMV, ndryshimi negativ: rritje e depozitave tek BPRMV.

Burimi: Ministria e Financave.

Normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore
në përqindje

Burimi: Ministria e Financave.

Në gusht 2024, në ankandet e rregullta, Ministria e Financave për bonot dymbëdhjetëmujore të sapoemetuara dhe bonot e thesarit pesëmbëdhjetëvjeçarë pa klauzolë valutore, mbajti normat e interesit përkatësisht në 3.8% dhe 5.6%, në nivelin e muajin e kaluar.



Rritje e lehtë e **borxhit publik**¹⁸ në fund të tremujorit të dytë nga viti 2024, në pjesë më të madhe nën ndikim të borxhit të brendshëm publik.

Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

¹⁸ Borxhi publik është definuar me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilës paraqet përmblendhje të borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të bazuara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë me pronësi të plotë ose të shumicës së shtetit ose të komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

Shtojca 1: Kategoritë treguese të konsumit personal dhe investimeve bruto

KATEGORITË INDIKATIVE PËR KONSUMIN PRIVAT

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	kor
	<i>ndryshime reale vjetore në %</i>										
Qarkullimi në tregtinë me pakicë*	-10.5	-14.9	-16.5	-21.3	-14.0	-11.7	-13.0	-4.1	-9.6	-8.7	7.3
Të ardhurat bruto nga TVSh-ja*	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	1.6	6.0	-13.4
Importi i mallrave për konsum të gjërë*	-2.8	-1.5	-2.1	-9.9	2.0	4.7	1.4	14.5	15.4	4.1	17.3
Prodhimi vendor i mallrave të konsumit	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-8.5	-7.1	25.0
Kreditë konsumatore*	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	2.9	3.9	4.6
Paga mesatare neto*	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	12.5	9.6	-
Transfertat private neto*	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.6	-12.1	-11.5	-
Pensionet*	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	17.1	10.2	9.8

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	kor
	<i>ndryshimet reale vjetore në %, përveç IHD-ve ku ndryshimet reale janë në milionë denarë</i>										
Importi i mjeteve për punë*	6.9	5.6	10.9	-1.3	-3.9	-1.9	-5.5	3.0	10.9	3.4	9.4
Punë ndërtimore të realizuara**	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	-
Prodhimi vendor i produkteve kapitale	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	10.6	-2.8	-20.1
Investime kapitale shtetërore*	-16.4	25.0	-47.3	55.6	-6.8	313.0	29.1	-4.0	27.5	-65.8	-40.0
Investime të huaja direkte***	9616.2	-6348.6	10624.7	262.4	1114.3	-2027.1	-8584.4	-1964.3	6277.5	4575.6	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	2.8	4.8	6.3
Stoqet e produkteve të gatshme	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	9.3	5.0	-

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

** normat reale të rritjes janë fituar duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve për ndërtimin e banesave të reja.

*** vlerat reale janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar vlerat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2023= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.